



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0261

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Batisha Ibrahim-Kryesese, Kimete Gashi- Brajshori dhe Vedat Poterqoi-Anëtar të Panelit Shqyrtues, duke vendosur sipas ankesës së OE PI ER TECHNICAL Kft Branch in Kosovo, kundër Vendimin për anulimin e procedurës së prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me rroba civile për zyrtarët policor” me numër të prokurimit 214-24-13303-1-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Policia e Kosovës, më 18.06.2025, mori këtë:



infoSOT

1. Aprovohet, si pjesërishtë e bazuar ankesa e PI ER TECHNICAL Kft Branch in Kosovo me nr. 2025/0261, e datës 11.04.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me rroba civile për zyrtarët policor”, me numër të prokurimit 214-24-13303-1-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues – Policia e Kosovës.

2. Mbetet në fuqi, B58 Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues - Policia e Kosovës për aktivitetin e prokurimit “Furnizim me rroba civile për zyrtarët policor”, me numër të prokurimit 214-24-13303-1-1-1.

3. Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si pjesërishtë e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 30.12.2024 Policia e Kosovës., duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Njoftimin për kontratë, për aktivitetin e prokurimit “Furnizim me rroba civile për zyrtarët policor”, me numër të prokurimit 214-24-13303-1-1-1.

Me 27.03.2025 Policia e Kosovës, ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin ku ka anuluar aktivitetin.

Me 01.04.2025, OE PI ER TECHNICAL Kft Branch in Kosovo, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim, e cila është refuzuar si e pa bazuar me Vendimin e AK të datës 03.04.2025.

Me 11.04.2025, OE PI ER TECHNICAL Kft Branch in Kosovo, ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokolli 2025/0261, duke e atakuar Njoftimin për kontratë.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 në paragrafin 10 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se është kompetent për shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vendosur mbi shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues PI ER TECHNICAL Kft Branch in Kosovo, janë parashtruar si në vijim:

Ne më dt. 27.03.2025, përmes platformës elektronike e-prokurimi, jemi njoftuar me njoftimin mbi vendimin e AK-së ku është anuluar aktiviteti i prokurimit, ndërsa ne jemi shpallur si tenderues i eliminuar me arsyetimin si në vijim:

Arsyet e autoritetit kontraktues për eliminimin tonë janë të paqëndrueshme për faktet si në vijim: Sa i përket arsyes se për artikullin 1, 2 dhe 4 nuk janë dorëzuar a-testet për materialin që nuk rrudhet, ju sqarojmë se mostrat e dorëzuara nga ana jonë janë prodhuar dhe testuar sipas specifikimeve teknike.

Gjatë ngarkimit të dokumenteve dhe dorëzimit të ofertës ka ndodhur një lëshim teknik nga ana jonë, ku nuk janë bashkangjitur edhe testimet e fundit për anti-wrinkle apo për testimin e materialit që nuk rrudhet.

Mirëpo, edhe përkundër këtij lëshimi teknik nga ana jonë, autoriteti kontraktues konform dispozitave të nenit 59.2 dhe 72 ka mundur të kërkojë sqarime shtesë në lidhje me mungesën e këtyre testeve, mirëpo një gjë të tillë nuk e ka bërë, edhe përkundër faktit që ne kemi qenë OE i vetëm ofertues në këtë aktivitet të prokurimit.

Në nenin 59.2 specifikohet qartë si në vijim: 2. Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit

të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues.

Sa për korrektësi dhe me qëllim që të vërtetojmë gjendjen faktike, që mostrat e dorëzuara nga ana jonë janë të testuara kundër rrudhjes, po ju bashkangjesim a-testet e lëshuara nga laborator i akredituar, e të cilat a-teste janë të lëshuara para datës së hapjes së ofertave. Në këtë rast të njëjtat a-teste janë konform paragrafit 3 të nenit 72 të LPP-së, ku përcaktohet qartë “3. Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive”.

Duke u bazuar në dispozitat e lartcekura, kuptohet qartë se autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me të njëjtat pasi që nuk na ka kërkuar sqarime në lidhje me mungesën e testimit për materialin që nuk rrudhet.

Sa për sqarim tuaj, siç edhe e dini, përveç këmishës dhe kravatës, të gjitha produktet tjera në përqindjen më të madhe kanë përmbajtje materiali leshin. Pasi që nga tenderi i kaluar AK-ja ka ndryshuar specifikat vetëm për pantollonat për zyrtarët/hetuesit policor, duke rritur % e materialit të leshit nga 70-75% në 90-97% lesh, ne kemi testuar dhe dorëzuar testin për anti-rrudhë. Nga një logjikë e thjeshtë do të duhej të kuptohej se nëse pantollonat me përmbajtje leshi 90-97% janë anti-rrudhë, e njëjta do të duhej të kuptohej edhe për setrë për zyrtarët/hetuesit policor dhe kati për zyrtarët policor pas që të gjitha këto produkte kanë përmbajtje të njëjtë të materialit (përkundrazi, % e materialit të leshit është më e vogël dhe e poliesterit më e madhe tek mostrat e kontestuara nga AK) dhe i vetmi dallim është tek pantollonat, ku AK-ja ka bërë ndryshimin e lartcekur. Për ta bërë më të qartë konstatimin e lartcekur, ju sqarojmë se përveç materialit të leshit, i cili hyn në kategorinë e materialeve natyrale, poliesteri është material sintetik që prodhohet në laborator dhe në përgjithësi të gjitha materialet sintetike si poliesteri, nyloni, elastani etj., janë materiale që kërkojnë më pak hekurosje për shkak të përbërjes së tyre kimike, pra të njëjtat në vetvete konsiderohen materiale anti-rrudhë, pasi rrudhen më pak dhe kërkojnë më pak hekurosje (shih elaborimin më poshtë):

<https://www.sahnifabrics.com/blogs/news/different-types-of-synthetic-fabrics?srltid=AfmBOor3JjktZ5IP2TmUGhwAhm3fWxs8JjBRZu5tmXiyJ-A9uAlQofaD>

Nga këto fakte konstatohet se çdo rrobë e prodhuar e cila në përmbajtje ka material poliester konsiderohet si anti-rrudhë. Në rastin tonë ju ritheksojmë se produktet si kati, setra dhe pantollonat kanë të njëjtin material sipas dosjes së tenderit, pra; material leshi dhe poliester, por i vetmi dallim qëndron sepse tek pantollonat AK-ja nga hera e kaluar ka ndryshuar % e materialit të leshit nga 70-75% në 90-97% lesh dhe 25-30% në 3-10% poliester. Sigurisht që ne për pantollonat kemi bërë testim të veçantë pasi që AK-ja kishte ndryshuar % e materialit, në këtë rast logjikisht mund të kuptohet se nëse të gjitha produktet në fjalë kanë në përbërje të njëjtin material, gramazhe, ngjyrë etj., por i vetmi dallim qëndron tek pantollonat dhe atë në % e materialit të leshit, dhe përderisa pantollonat janë anti-rrudhë, atëherë e njëjta duhet të kuptohej edhe për produktet tjera – mostrat e dorëzuara, pasi që materiali është i njëjtë.

Me kërkesë për rishqyrtim po i bashkangjesim raportet e testimeve për materialin që nuk rrudhet në gjuhën kineze dhe të njëjtat raporte të përkthyer i gjeni edhe në gjuhën angleze. Njëkohësisht me këtë kërkesë për rishqyrtim për secilin nga raportet e testimit po i

bashkangjesim edhe dëshmitë nga interneti të cilat ju shfaqen në momentin që bëhet skanimi i scan codit nga raportet e testimit ku figuron qartë që është bërë testimi i materialit dhe produkteve për anti-wrinkle. (Të njëjtat i gjeni në faqet e fundit të secilit raport të testimit). Sa për ilustrim, kur skanohet testi për anti-rrudhë në platformën e laboratorit (të akredituar) shfaqen këto rezultate, ku qartazi shifet që materiali i përdorur për prodhimin e mostrave është trajtuar dhe testuar për anti-rrudhë, për më shumë shih ilustrimin:

Rezultati online pas skanimit: Të bashkëngjitur e gjeni dëshminë në raportin e ekspertit.

Gjithashtu, sa për informimin tuaj, rezultatet normale të testimeve për anti-rrudhë janë nga 3.0-3.9 (shih foton e mëposhtme), ndërsa rezultatet tona të testimeve të cilat i gjeni në faqet e dyta të raporteve të cilat po i bashkangjesim edhe më poshtë janë 4-4.5, e që i bie se përveç që mostrat e dorëzuara i kemi testuar për anti-rrudhë, njëkohësisht të njëjtat rezultate janë më të larta se sa testimet normale që zakonisht bëhen në industrinë e tekstilit, përkatësisht rezultatet tona janë pothuajse në shkallën e fundit të rezultateve për anti-rrudhë.

(Bashkëngjitur gjeni studimin AATCC TM124-2018t në lidhje me metodat e testimit dhe shkallët e testimit).

Kati dhe Setra: Të bashkëngjitur e gjeni dëshminë në raportin e ekspertit.

Këmisha: Të bashkëngjitur e gjeni dëshminë në raportin e ekspertit.

Kravata: Të bashkëngjitur e gjeni dëshminë në raportin e ekspertit.

Dëshmitë të cilat po i bashkangjesim dëshmojnë qartë se të gjitha mostrat e dorëzuara tek AK-ja janë prodhuar konform kërkesës së dosjes së tenderit dhe se materiali për prodhimin e mostrave është trajtuar/testuar për anti-rrudhë dhe këtë e dëshmojnë testet e laboratorit i cili ka konfirmuar me shkrim tek AK-ja vërtetësinë e testeve dhe po të njëjtat janë të publikuara online dhe që janë testuar para afatit të hapjes së tenderit.

Për më shumë ju lutem shikoni të bashkëngjiturat për testet dhe përkthimet e tyre. Ne ju lutemi shumë që kjo kërkesë e rishqyrtimit të konsiderohet në mënyrë të drejtë dhe të bëhet verifikimi i duhur i mostrave dhe dokumentacionit të dorëzuar nga ana jonë, sepse siç theksuam më lartë, mostrat e dorëzuara janë të vetmet mostra të cilat janë testuar në laborator dhe nuk ka pasur mundësi autoriteti kontraktues që të kërkojë sqarime në lidhje me mungesën e testeve për materialin anti-rrudhë, përkundër dispozitave të LPP-së.

Kërkojmë që sa më parë të bëhet rishqyrtimi i ankesës tonë, me qëllim që të jemi pjesë e këtij aktiviteti të rëndësishëm.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim:

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE PI ER TECHNICAL Kft Branch in Kosovo

AK nuk ka shkelur nenin 1 “Qëllimi i LPP-së”, pasi autoriteti kontraktues ka respektuar në tërësi qëllimin e këtij ligji, i cili është të sigurojë menaxhim më efikas, më transparent dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë, si dhe të sigurojë integritet dhe përgjegjësi të zyrtarëve përgjegjës, transparencë dhe jo-diskriminim. AK ka publikuar njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit me procedurë të hapur, duke mos vendosur asnjë kriter apo specifikë e cila

do të kishte pamundësuar aplikimin e ndonjë OE.

AK nuk ka shkelur nenin 7 “Barazia në Trajtim”/Jo të LPP-së, pasi të gjithë OE janë trajtuar në mënyrë të barabartë sipas kërkesave në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë dhe specifikave teknike. Po ashtu, AK nuk ka diskriminuar apo favorizuar asnjë OE përmes kësaj procedure. AK ka hartuar specifikat teknike të cilat janë në harmoni me LPP-në dhe nuk kanë asnjë kufizim apo favorizim, dhe oferta juaj dhe mostrat janë trajtuar në harmoni të plotë me kërkesat e dosjes dhe specifikat teknike.

AK nuk ka shkelur nenin 59 “Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve” dhe nenin 40 të rregullores 001/2022. AK ka respektuar në harmoni të plotë nenin 59 të LPP-së pasi ka vlerësuar, ekzaminuar dhe krahasuar ofertën në harmoni të plotë me LPP-në dhe kriteret e përcaktuara në dosjen e tenderit. Në dosjen e tenderit është kërkuar: c) Atestet laboratorike — Operatori Ekonomik duhet të ofrojë atestet laboratorike për secilin artikull sipas specifikave teknike të hartuara (atestet për përbërjen e materialit, duhet të kenë qëndrueshmëri në ngjyrë që të mos tjetërsohet, materiali që nuk rrudhet, duhet të kenë qëndrueshmëri në qepje). OE për këtë pikë ka dorëzuar atestet si më poshtë: atestin me numër 039T/25 të datës 28.02.2025 nga laboratori MAKKONTROL, atestin me numër 2024-08EC060692G të datës 28.06.2024 të lëshuar nga Chongqing Metrological Quality Testing Institute, atestin me numër 2024-08EC060690 të datës 28.06.2024 të lëshuar nga Chongqing Metrological Quality Testing Institute, dhe atestin me numër 2024-08EC060697 të datës 28.06.2024 të lëshuar nga Chongqing Metrological Quality Testing Institute. Ju vetën në atestin e parë keni paraqitur testues në lidhje me materialin që nuk rrudhet, ndërsa në tre atestet e tjerë nuk ka paraqitur testues.

Në kërkesën për rishqyrtim keni dorëzuar ateste të tjera me datë të ndryshme, të cilat në asnjë formë nuk mund të pranohen, pasi këto nuk janë sqarime por dokumentacion i ri, i cili bie ndesh me LPP-në, sepse këto ateste përbëjnë ndryshim material.

AK nuk ka shkelur nenin 60 “Kriteret për Dhënien e Kontratës”. AK në harmoni me LPP ka përcaktuar kriterin për dhënie të kontratës, i cili ka qenë oferta e përgjegjshme me çmimin më të lirë. Ju nuk e keni plotësuar këtë kriter pasi jeni ofertues i papërgjegjshëm në aspektin administrativ dhe teknik.

AK nuk ka shkelur nenin 62 “Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit” dhe nenin 43 të rregullores 001/2022. AK në harmoni të plotë me nenin 62 ka anuluar aktivitetin e prokurimit pasi nuk kemi pasur asnjë ofertë të përgjegjshme sipas kërkesave dhe planifikimeve të AK-së. Oferta e dorëzuar nga ana juaj ka qenë e papërgjegjshme në aspektin administrativ dhe teknik.

AK nuk ka shkelur nenin 69 “Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale”. Në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë, AK ka përcaktuar kërkesat në lidhje me aftësinë teknike dhe profesionale dhe ndër kërkesat ka qenë edhe ateste laboratorike, ku është kërkuar atest për materialet që nuk rrudhen, të cilin ju në ofertën tuaj nuk e keni pasur.

AK nuk ka shkelur nenin 72 “Dokumentacioni dhe Informacioni Shtesë”. AK nuk ka kërkuar sqarime pasi nuk ka pasur asnjë fakt që mund të tregojë ekzistencën e ndonjë dokumenti apo atesti i cili mund të pranohet apo të trajtohet nga ana e komisionit. Në kërkesën për rishqyrtim ju keni prezantuar disa ateste të cilat janë dokumentacion krejtësisht i ri dhe për rrjedhojë përbëjnë ndryshim material, gjë që ligji nuk e lejon.

Policia e Kosovës, në përputhje me nenin 108/A, paragrafi 10.1, refuzon kërkesën tuaj për shqyrtim si të pabazuar.

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka caktuar Panelin Shqyrtues sipas nenit 111, paragrafi 5 (ii) të LPP dhe ka angazhuar ekspertin shqyrtues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 (i) të LPP, me detyrë që i njëjti ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me këtë aktivitet të prokurimit, në kuptim të nenit 113 dhe 114 të LPP lidhur me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së cituar. Lidhur me këtë, me 30.04.2025, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit rekomandime të cilat përshkruhen si në vijim:

Ankesa të refuzohet si e pabazuar,

Mbetet në fuqi vendimi i AK.

Paneli konstatoi paraprakisht se Raporti i ekspertizës i përmban elementet qenësore sikurse kërkohet me nenin 113, paragrafi 3 të LPP dhe i njëjti është pranuar nga të dyja palët, konform nenit 115 të LPP lidhur me nenin 20 të Rregullores së cituar. Ankuesi nuk është pajtuar me raportin e cituar përderisa AK është pajtuar me raportin e ekspertit. Krahas kësaj konstatohet se palët janë të informuara reciprokisht lidhur me shkresat kësaj lënde (nga platforma e prokurimit elektronik) në pajtim me paragrafin 2, të nenit 20 të kësaj Rregulloreje prandaj ka kushte që Paneli të vendosi në mënyrë meritorë përkitazi me ankesën.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se paneli plotëson kushtet për të vendosur në këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së cituar të OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtrirat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtrirat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE PI ER TECHNICAL Kft Branch in Kosovo, eksperti shqyrtues/ teknik përmes raportit nr. 2025/0261 ka vlerësuar si në vijim:

Duke pasur parasysh ankesën e dorëzuar në OSHP të Operatorit Ekonomik PI ER TECHNICAL Kft Branch in Kosovo pjesëmarrës në aktivitetin e prokurimit FURNIZIM ME RROBA CIVILE PËR ZYRTARET POLICOR me numër të prokurimit 214-24-13303-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – POLICIA E KOSOVËS –

Në cilësinë e ekspertit teknik për shqyrtimin e pretendimeve ankimore dhe verifikimin e mostrave me datë 29.4.2025 në orën 14:00 është bërë verifikimi teknik i mostrave në Autoritetin Kontraktues dhe sipas pretendimeve ankimore dhe specifikimet teknike të detyrueshme aneksi 1 si më poshtë:

Specifikimet teknike të verifikuara nga ekspertët teknik sipas pretendimeve ankimore

1. SPECIFIKAT PËR KËMISHA PËR ZYRTARËT/HETUESIT POLICOR

Pika 3 nga AK është kërkuar: Material që e mban hekurosjen dhe që nuk rrudhet

Specifika teknike të verifikuara nga mostrat

Eksperti teknik sqaron, se te pika 3 gjate verifikimit te kemishes - Materiali nuk e mban hekurosjen dhe rrudhet shume lehte aty per aty.

2. SPECIFIKAT PËR SETËR PËR ZYRTARËT/HETUESIT POLICOR

Pika 3 nga AK është kërkuar: Setra nuk duhet te jete e njejte si e katit mirpo duhet te jete me e perditshme (e ilustruar si ne foto)

Pika 5 Materiali i brendeshem (astari) te jete nje ngjyresh te pershtatet me ngjyren e setres dhe që nuk rrudhet

Specifika teknike të verifikuara nga mostrat

Eksperti teknik sqaron se: Pika 3 Setra eshte gati e njejte si e katit dhe nuk eshte me e perditshme (e ilustruar si ne foto), Pika 5 Materiali i brendeshem (astari) eshte nje ngjyresh dhe pershtatet me ngjyren e setres por

Rrudhat shfaqen me pak dhe jan me pak te dukshme aty ketu.

3. SPECIFIKAT PËR RRUBAT (LIGAJTE KATI) PËR ZYRTARËT POLICOR

Pika 7 nga AK është kërkuar: Te jete material që mban hekurosjen dhe që nuk rrudhet

Specifika teknike të verifikuara nga mostrat

Eksperti teknik sqaron se: Pika 7 Rrudhat shfaqen me pak dhe jan me pak te dukshme aty ketu.

4. SPECIFIKAT PËR PANTOLLONA PËR ZYRTARËT/HETUESIT POLICOR

Pika 3 nga AK është kërkuar: Material që nuk rrudhet, duhet te jene te perditshem dhe jo solemn si te katit

Specifika teknike të verifikuara nga mostrat

Eksperti teknik sqaron se: Pika 3 Rrudhet shfaqen me pak dhe jane shume me te lehta per t'u hequr, kan shume pak dallim nga pantollonat solemne te katit.

Bazuar në pretendimet ankimore dhe duke krahasuar sipas specifikave te kerkuara ne pergjithesi janë bërë këto verifikime teknike të mostrave dhe nuk jan te sakta aty ketu sipas specifikave.

Eksperti shqyrtues, sqaron se përgjigjjet në pretendime ankimore janë dhënë nga Eksperti teknik profesional.

-Gjetjet e Panelit Shqyrtues-

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktivitetit të prokurimit, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues dhe ekspertit teknik mendimet e tij janë të pranueshme

duke ju referuar edhe mostrave të dorëzuar nga OE ankues e të cilat ekspertit teknik i ka ekzaminuar pranë AK-se duke ofruar edhe foto si dëshmi dhe se Paneli Shqyrtues me të drejtë e mori në konsideratë Raportin e tij me rastin e vendosjes.

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues dhe i atijë teknik, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik Paneli Shqyrtues ankën e OE e aprovon si pjesërisht të pazuar duke u bazuar në dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit OE ankues i ka sjellur atestet e kërkuara me DT, por që janë të pamjaftueshme për të dëshmuar se materiali i ofruar nuk mund të rrudhet këtë e konfirmon edhe ekspertit teknik por mund të shihet edhe në foto të dokumentuara në raportin e ekspertizës për çka këtë e pranon edhe ankuesi në përgjigjen e tij/saj ndaj raportit të ekspertizës i cili citon: *"Sa për sqarim ju informojmë se nuk ekziston asnjë material në industrinë e tekstilit i cili nuk rrudhet asnjëherë dhe këtë gjë ekspertit teknik e din shumë mirë"*, po ashtu i njëjti citon: *"raporti i ekspertit është lëshuar pothuajse pas gati 2 muajsh, ku produktet me të cilat kemi ofertuar kanë qëndruar gjatë asaj kohe tek AK dhe normalisht që do të shfaqen rrudha tek produktet"*. Rrudhjen e materialit e pranon edhe ankuesi i cili është dashur që para ofertimit, gjatë fazes së tenderimit ta sqarojë me AK lidhur me atë që nuk ka material në industrinë e tekstilit i cili nuk rrudhet. Andaj duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin konstatimeve dhe rekomandimeve në raportin e ekspertit shqyrtues dhe teknik.

Rrjedhimisht, Paneli Shqyrtues ka vendosur se mbetet në fuqi B58Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues Policia e Kosovës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me "Furnizim me rroba civile për zyrtarët policor", me numër të prokurimit 24-24-330.1-1.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahim

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit.



Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - POLICIA E KOSOVËS**
- **OE - PI ER TECHNICAL Kft Branch in Kosovo**
- Arkivës së OSHP-së: